

AKT(KONTRATE)-THEMELIMI

PER SHOQERINE PRIVATE "GJELBERIMI" hartohet nga i quqjturi Pjeter Trashaj i biri i Gjinit dhe i Mrikes i dt. 17.9.1948 lindur dhe banues ne Lezhe.

Sot me date _____ 1994, me deshiren dhe vullnetin tim te plote mora vendimin qe te krijoji shoqerine private "Gjelberimi"(SHPK) me seli ne Lezhe .Me kalimin e kohes seline e kesaj shoqerije mund ta ndryshoje qendren e saj.

Veprimtarija e shoqerise qe po krijoj do te konsistoje :

1. Ne fushat e ndryshme te sektorit pyjeve ,kullotave bimeve MTE
 - a. Mbarshtimi i pyjeve, kullotave, faunes, sistemime malore.
 - b. Mbrojtje pyjesh(nga smundjet demtuesit e zjarret)
 - c. Ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe.
 - d. Shfrytezimin e pyjeve , bimeve MTE e prodhimeve tjera pyjore. si dhe perpunimin e tregtimin e tyre.
2. Ne fushat e nryshme tregtare:
 - a. Eksport import, tregtim me shumice e pakice art. ndryshem industrial, ushqimor, blektoral, bime MTE, makineri e paisje tregtim e perpunim te materialit drusor, ndertimi, elektrik plehra kimike, servise riparim-sherbimi, ne fushen e ndertimeve karburanteve me shumice e pakice.

Ne aktivitet do te ushtroj si ortak i vetem pa pjesmarrjen e te tjerave me kapital themeltar 100000(Njeqindmije) leke .Kete akt themelimi e mbeshtes ne ligjin Nr.7512 date 10.8.1992, ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 vendimin e KM.Nr.36 date 31.1.1994 dhe udhezimin e M.B.U.Nr.2.17.6.94 dhe mbasi te regjistrohem si person juridik i, kesaj shoqerije nga organe kompetente ne gjykaten e rrethit Tirane dhe perfundimisht ne zyren perkatese tatimore do te filloj aktivitetin sipas objekteve siper shenuar dhe te percaktuar ne statusin e shoqerise dhe te specifikuar ne vendimin e gjykates ne fjale .Ne aktivitetin tim ne kete shoqeri do ti permbahem statutit te hartuar pe kete qellim dhe do te respektoj si dispozitat ligjore ne fuqi eshte dhe ato qe do te dalin me vone per veprimtarite private te organizimit punes ne pyje-kullota-bime dhe atij tregtar.

Ky akt themelimi u hartu ne 3(tre) kopje nga te cilet nje ruhet ne gjykaten e rrethit Tirane nje ne zyren perkatese tatimore dhe nje kopje ne dekomentat e shoqerise .Nenshkruhet rregullisht nga une themeluesi i kesaj shoqerije private.

ORTAKU I VETEM I THEMELIMIT TE SHOQERISE PRIVATE "GJELBERIMI "

-Pjeter Trashaj-

S T A T U T I

I SHOQERISE PRIVATE "GJELBERIMI" ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.
(SH.P. K.)

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7512 dt.10.8.1992 dhe te ligjit NR.761 dt.19.11.1992 si dhe Vendimit KM.Nr.36 dt.31.1.1994 e udhezimit MBU.Nr.2.dt.17.6.1994 une i quajturi Pjeter Gjini Trashaj ku si themelues i shoqerise private "Gjelberimi" sot me date _____1994 duke patur detyrime zotesine juridike per te vepruar shpall per sa vijon:

"Formimin e shoqerise private "Gjelberimi" ne Lezhe

F O R M I M I

Neni 1

Formohet shoqerija private "Gjelberimi" me themelues PjeterTrashaj i biri i Gjinit dhe i Mrikes i dt.17.9.1948 lindur e banues ne Lezhe.

QENDRA E SHOQERISE

Neni 2

Qendra e shoqerise "gjelberimi" do te jete ne Lezhe por me kalimin e kohes mund te ndrojoj vend qendrim ne qytete te tjera te Shqiperise dhe te hape degje te reja ne keto qytete.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 3.

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise private "Gjelberimi" eshte e pa kufizuar dhe mund te zgjase mbi 10-vjet por dhe mund te shperndalet ne qdo kohe dhe pe qdo shkak .

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SHOQERISE

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise "Gjelberimi" eshte:

1. Ne fushat e ndryshme te sektorit Pyjeve-kullotave e bimeve MTE

a. Mbarshtimi i pyjeve ,kullotave,faunes e bimeve MTE.

b. Pyllezime permirsime pyjore ,sistemime malore.

c. Mbrojtje pyjesh(nga smundjet demtuesit e zjarret)

d. Ndretimi dhe meremetimi i veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota dhe livadhe.

e. Shfrytezimi i pyjeve , bimeve MTE, e prodhimeve tjera pyjore si dhe perpunimi dhe tregtimi tyre.

2. Ne fushat e ndryshme tregtare :

-Eksport import , tregtim me shumice e pakice art te ndryshem

industrialo ushqimor ,blektoral;bime MTE makineri e paisje ,tregtim e perpunim te materialit drusor ,ndretimi ,elektrik,plehra kimike servise riparim sherbimi, ne fushen e ndrtimeve e karburanteve me shumice e pakice.

Kapitali i shoqerise perbehet nga nje kapital fillestar prej 100000(njeqindmije) lekesh kontribut i vete themeluesit te shoqerise Pjeter Trashaj.Kapitali i kesaj shoqerije me pe gjegjesi te kufizuar do te shtohet ose do te pakesohet me kalimin e kohes sipas vendimit qe do te marre pronari i saj.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI
Neni 6

Shoqerija private "Gjelberimi"deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ne ate te ligjleslacionit ne fuqi.

Ajo eshte krijuar dhe do te veproje ne pe puthje me ligjen e miratuar nga Kuvendi Popullor Nr.7512 dt.10.8.1991"Per saksionimin e mbrojtjen e prones private" "Nismes se lire te veprimtarise private dhe te privatizimit te ligjit Nr.7639 dt.19.11.1992 si dhe vendimin e KM. Nr.36 dt.31.1.1994 si dhe udhezimit MBU. N.2 17.6.1994 si dhe ligjeve te tjera qe do te shpallen pe kete qellim.

Shoqerija private gjelberimi vepron si person juridik nga koha dhe dita e regjistrimit te saj ne gjykaten e Tiranës, ndresa do te ushtroj veprimtarine e saj ekonomike me marrjen e lejes se ushtrimit veprimtarise private nga zyra perkatese tatimore.

Neni 7

Shoqerija private "Gjelberimi " ka vulen e saj me mbishkrimin "Gjelberimi-Lezhe-Albania ne forme drejtekendeshi.

Neni 8

Shoqerija private "Gjelberimi" merr per siper te drejta e detyrime ,me regjim te punes private,Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktuale e jasht kontraktuale brenda kapitalit te saj dhe punes saj te fituar.

Neni 9

Shoqerija private "Gjelberimi" eshte e krijuar dhe prone e veteme e zt.Pjeter Trashaj,vendimet e marruna naga pronari aktual si dhe ato vendime te marruna ne ratet e bashkimit te aktiviteteve te kesaj shoqerije me ortak te tjere si bashkpronar te zbatimit te ligjeve ne fuqi sipas ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithë

administratoret dhe te punesuarit ne kete shoqeri

Neni 10

Administratori i kesaj shoqerije eshte njekohesisht dhe pronari i saj sipas nevojave qe paraqiten ne zhvillimin e veprimtarise ekonomike dhe asaji financiare emron administrator ne qender dhe ne degjet e shoqerise si dhe puneson punetor sipas nenit 4 te ketij statuti -ti duke espektuar ligjin "Mbi mardhenjet e punes"

Neni 11

Administratori i shoqerise dhe me autorizimin e tij administratorët e emruar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite ligjore per drejtesine e drejtimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloji perjashtimi dhe i kane mundesite ti kryjne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojsheme per arritjen e qellimit te shoqerise .Ato kane te drejte te blejne te shesin ,kembejne pasuri, lende te para qe lidhen me veprimtarine e shoqerise ,te lidhen me shorite e huja ose te vendit duke siguruar pjesmarrjen per qellimin e veprimtarise perfunduarve nenin 4 si dhe te kryjne per çdo lloji veprimi prane te gjitha institucioneve shtetore ose private .^Ne kete rat administratoret e ngarkuar nga pronari i shoqerise japin llogari para tij.

Neni 12

Pronari i shoqerise cakton administratoret te cileve ne aktin e emrimit u percakton te drejtat dhe detyrat dhe masen e pages .Po keshtu vepron dhe me puntoret e punesuar me te cilet lidh kontraten e punes ne perputhje me ligjet ne fuqi.Te gjitha te punesuarit jane te detyruar te parnojne statutin e kesaj shoqerije.

Neni 13

Administratoret nuk mund te marrin cilesine e ortakut ne shoqerine private "Gjelberimi" as dhe te ushtrojne aktivitetet konkurruese te çdo lloji per llogari te tyre ose te treteve,perveç rateve autorizuara nga pronari i shoqerise.Per çdo shkelje administratorët ose te punesuarit largohen nga puna dhe pergjigjen per demin.

Neni 14

Te gjitha shpenzimet e nevojsheme, per mbajtjen e te punesuarve perballohen nga vete shoqeria "Gjelberimi"

Neni 15

Perfaqesuesi i shoqërisë do të behet nga pronari saj dhe prej administratoreve eventual, të caktuar prej tij si në qender ashtu dhe filjalet e saj. Në vendim të pronarit administratorët zevendesohen. Pronari dhe administratori i shoqërisë kanë të drejtë ta perfaqesojnë shoqërinë "Gjelberimi" në organet gjyqësore në gjykime si dhe para institucioneve shtetërore si dhe të caktoj avukat mbrojtës për çështjen në gjyq.

Sekreti i punës

Neni 16

Të gjithë të emruarit në shoqëri janë të detyruar ta ruajnë sekretin e punës së saj. Sekret pune paraqesin shkresat, materialet, akte të cilet me ligj të veçantë dhe vendime të nxjerra nga pronari përbejnë sekret pune. Të dhenat informative, bilançet, plani dhe informacioni mbi politiken ekonomike të shoqërisë që ju jepen organeve përkatëse sipas ligjit nënshkruhet nga pronari. Detyrat mbi ruajtjen e sekretit të punës nga të punësuarit vazhdon dhe pas largimit tyre nga shoqëria.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 17

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë "Gjelberimi" mbyllet me 31. Dhjetor të çdo viti përveç urdherave të veçanta që jep pronari për këtë qëllim. Në fund të periudhës ushtrimore (mujo e 3/mujore) shoqëria nxjerr bilançin kontabel të saj me rezultate ekonomike, fitime e humbje bazuar në ligjet në fuqi e në rregullat e mbajtjes kontabilitetit. Bilançi kontabel i shoqërisë miratohet dhe nënshkruhet nga pronari i saj. Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve të akumulimit dhe të detyrimeve fiskale të mbeten përdorim pronarit të shoqërisë ose bashkëpunësve, nëse do të ketë të tilla. Është e drejta pronarit të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto të krijuara si dhe përdorimin e tyre. Pjesa e fitimit neto që i përket pronarit shqiptar ose antareve të shoqërisë mund të transfirohen lirisht jashtë shtetit shqiptar pa kufizim bazuar në ligjin Nr. 7594 dt. 4.8.1992.

SHPERNDARJA E SHOQËRISE

Neni 19

Shpërndarja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë dhe për çdo shkak. Pronari i shoqërisë vendos e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidar dhe duke ju përcaktuar detyrat. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë derisa të dorzohet.

personave fizik ose juridik ,duke likujduar ne radhe te pare detyrim
ndaj personave te trete qe mund te kete shoqeria.

Neni 19.

Shoqeria private "Gjelberimi " ka numerin e llogarise rrjedhese te
regjistruar ne arken e shtetit Shqiptar ne Lezhe.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 20

Ky statut redaktohet ne disa kopje nga te cillet nje kopje mbahet
ne zyren e noterise qe kryen veprimin noterial ,nje kopje gjykata
e rrethit Tirane qe kryen regjistrimin e shoqerise si person juridik
nje kopje dorzohet zyres perkates tatimore me dekomtat e tjere
perkates dhe nje kopje mbetet si pjese e dekomtacionit vshoqerise
"Gjelberimi"

STATUTI NENSHKRUHET R EGULLISHT NGA PRONARI I KESAJ
SHOQERIE

PRONARI DHE ADMINISTRATORI I SHOQERISE PRIVATE "
"Gjelberimi"-

PJETER GJIN TRASHAJ

